

URDHËR
Nr. 54, datë 15.1.2026

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 916, DATË 22.9.2025, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE TË DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SERBISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 916, datë 22.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Serbisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri